

ANEKS 4
FORMULARI I DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË TATIMIT MBI TË ARDHURAT E
KORPORATËS

(zëvendësuar me udhëzimin nr. 4, datë 4.2.2025)

FORMULARI I DEKLARIMIT DHE I
PAGESËS SË TATIMIT MBI TË
ARDHURAT E KORPORATËS



(2) Periudha tatimore

(1) Numri Serial: _____

Numri Identifikimit të Personit të Tatueshëm (NIPT): (3) _____
Emri Tregtar i Personit të Tatueshëm: _____
Adresa: Qyteti/Bashkia/Rrethi: (4) _____
(5) _____

Llogaritja e rezultatit

Të ardhurat dhe shpenzimet

(7/8) Të ardhura nga aktiviteti ekonomik kryesor

(9/10) Të ardhura nga aktivitete të tjera dhe të ardhura të tjera të shfrytëzimit

(11/12) Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse dhe ose dividendi

(13/14) Të ardhura nga investimet dhe huat e tjera pjesë e aktiveve afatgjata

(15/16) Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme

Të ushtrimit	Tatimore
(7)	(8)
(9)	(10)
(11)	(12)
(13)	(14)
(15)	(16)

(17/18) Të ardhura të tjera që nuk përfshihen në rubrikat më lart

(17)	(18)
(19)	(20)

(19/20) Të ardhurat Total

(21/22) Kosto e mallrave, produkteve, apo shërbimeve të shitura

(21)	(22)
(23)	(24)
(25)	(26)
(27)	(28)
(29)	(30)
(31)	(32)
(33)	(34)

(23/24) Shpenzime të punës (paga + sigurime shoqërore e shëndetësore)

(25/26) Shpenzime administrative

(27/28) Amortizimi

(29/30) Shpenzime interesi dhe shpenzime të tjera të ngjashme

(31/32) Shpenzime të tjera financiare

(33/34) Shpenzime të tjera

(35/36) Shpenzimet total

(35)	(36)
------	------

(37) Shpenzimet e pazbritshme

(37)

Rezultati

(38/39) Humbja (38) = (35) - (19) kur (35) > (19)

(38)	(39)
------	------

(39) = (36) - (37) - (20) kur (36) - (37) > (20)

(40/41) Fitimi (40) = (19) - (35) kur (19) > (35)

(40)	(41)
------	------

(41) = (20) + (37) - (36) kur (20) + (37) > (36)

(42) Humbje e mbartur

(42)

(43) Fitimi i tatueshëm neto (39) = (37) - (38)

(43)



Llogaritja e tatimit mbi të ardhurat e korporatës

Përcakto vlerën për kuti (44) (46) (48)

Baza e tatueshme

Tatimi

(44/45) Tatimi mbi të ardhurat e korporatës me shkallë tatimore standarde 15%

(44)	(45)
------	------

(46/47) Tatimi mbi të ardhurat e korporatës me shkallë tatimore të reduktuar 5%

(46)	(47)
------	------

(48/49) Tatimi mbi të ardhurat e korporatës me shkallë tatimore të tjera

(48)	(49)
(50) Totali i tatimit	(50)
(51) Kreditimi i tatimit të huaj	(51)
(52) Kreditimi i tatimit të mbajtur në burim	(52)
(53) Tatimi mbi të ardhurat e korporatës i shtyrë	(53)
(54) Tatim mbi të ardhurat e korporatës i detyrueshëm për t'u paguar	(54)
(54)=(50)-(51)-(52)- (53)	

A. UDHËZUESI I PLOTËSIMIT TË FORMULARIT TË DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË TATIMIT MBI TË ARDHURAT E KORPORATËS

B. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

1. *Numri serial* gjenerohet nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve dhe shërben për të përditësuar regjistrimet kur paraqitet deklarata.
2. *Periudha tatimore* është vjetore.
3. *Numri i identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT)* është numri i dhënë nga QKB dhe që identifikon personin e tatueshëm.
4. *Emri tregtar i personit të tatueshëm* është emri me të cilin paraqitet veprimtaria dhe që shënohet në certifikatën e NIPT-it.
5. *Adresa* tregohet vendi kryesor i ushtrimit të veprimtarisë. Kjo adresë është e treguar edhe në certifikatën e NIPT – it.
6. *Numri i telefonit* (nëse ka) tregon numrin e telefonit në vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike.

C. TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET

Llogaritja e rezultatit

7. *Të ardhurat nga aktiviteti ekonomik kryesor (ushtrimore)* janë të ardhurat kontabël nga aktiviteti ekonomik kryesor gjatë periudhës ushtrimore.
8. *Të ardhura nga aktiviteti ekonomik kryesor (tatimore)* janë të ardhurat e faturuara për aktivitetin ekonomik kryesor që i përkasin periudhës tatimore.
9. *Të ardhura nga aktivitete të tjera dhe të ardhura të tjera të shfrytëzimit*, përfshihen të gjitha të ardhurat e papërfshira në pikën 7, nga aktivitete të tjera të periudhës ushtrimore.

10. Të ardhura nga aktivitete të tjera dhe të ardhura të tjera të shfrytëzimit, përfshihen të gjitha të ardhurat e faturuara të papërfshira në pikën 8, nga aktivitete të tjera të periudhës tatimore.

11. Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse dhe/ose dividendi, janë të ardhurat kontabile të përlogaritura sipas ligjit për kontabilitetin nga entiteti në të cilat ai ka interesa pjesëmarrëse gjatë periudhës ushtrimore.

12. Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse dhe/ose dividendi, janë të ardhurat tatimore nga entitetet ku kanë interesa në pjesëmarrje dhe/ose dividendi dhe të cilat nuk plotësojnë kriteret e përjashtimit nga fitimi i tatuashëm referuar përcaktimeve në nenin 29, të ligjit për tatimin mbi të ardhurat.

13. Të ardhura nga investimet dhe huat e tjera pjesë e aktiveve afatgjata (ushtrimore), janë të ardhurat kontabël të përlogaritura sipas ligjit për kontabilitetin nga investimet dhe huat e tjera pjesë e aktiveve afatgjata gjatë periudhës ushtrimore.

14. Të ardhura nga investimet dhe huat e tjera pjesë e aktiveve afatgjata (tatimore), janë të ardhurat tatimore nga investimet dhe huat e tjera pjesë e aktiveve afatgjata gjatë periudhës tatimore.

15. Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme, janë të ardhurat kontabël të përlogaritura nga entiteti sipas ligjit për kontabilitetin nga interesat dhe të ardhura të tjera të ngjashme gjatë periudhës ushtrimore.

16. Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme, janë të ardhurat tatimore të përlogaritura nga entiteti nga interesat dhe të ardhura të tjera të ngjashme gjatë periudhës tatimore.

17. Të ardhura të tjera që nuk përfshihen në rubrikat e tjera gjatë periudhës ushtrimore janë të ardhurat kontabël të përlogaritura sipas ligjit për kontabilitetin, që nuk përfshihen në të ardhurat e rubrikave: 7, 9, 11, 13,15.

18. Të ardhura të tjera që nuk përfshihen në rubrikat e tjera gjatë periudhës tatimore janë të ardhurat tatimore të përlogaritura nga entiteti gjatë periudhës tatimore, që nuk përfshihen në të ardhurat e rubrikave: 8, 10, 12, 14, 16.

19. Të ardhurat total (ushtrimore) janë shuma e të ardhurave nga rubrikat ushtrimore $7 + 9 + 11 + 13 + 15 + 17$.

20. Të ardhurat total (tatimore) janë shuma e të ardhurave nga rubrikat tatimore $8 + 10 + 12 + 14 + 16 + 18$.

21. Kosto e mallrave, produkteve apo shërbimeve të shitura (ushtrimore) janë shpenzimet kontabël të përlogaritura nga entiteti në lidhje me kostot e mallrave, produkteve apo shërbimeve gjatë periudhës ushtrimore, sipas PASH.

22. Kosto e mallrave, produkteve, apo shërbimeve të shitura (tatimore) janë shpenzimet lidhur me kostot e mallrave, produkteve apo shërbimeve gjatë periudhës tatimore, sipas PASH-it.

23. Shpenzime të punës (paga + sigurime shoqërore e shëndetësore) (ushtrimore) janë shpenzimet e përlogaritura sipas ligjit për kontabilitetin lidhur me pagat, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, si dhe shpenzime të tjera lidhur me personelin gjatë periudhës ushtrimore.

24. Shpenzime të punës (paga + sigurime shoqërore e shëndetësore (tatimore) janë shpenzimet e përlogaritura sipas ligjit për kontabilitetin lidhur me pagat, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, si dhe shpenzime të tjera lidhur me personelin gjatë periudhës tatimore.

25. Shpenzime administrative (ushtrimore) janë shpenzime të llogaritura nga entiteti sipas përcaktimeve në ligjin për kontabilitetin dhe të pasqyruara në PASH, gjatë periudhës ushtrimore.

26. Shpenzime administrative (tatimore) janë shpenzime të llogaritura nga entiteti sipas përcaktimeve në ligjin për kontabilitetin dhe të pasqyruara në PASH, të cila shërbejnë për sigurimin dhe ruajtjen e së ardhurës së tatuashme, gjatë periudhës tatimore.

27. Amortizimi (ushtrimore) është përlogaritje e shpenzimeve nga entiteti sipas parimeve të ligjit për kontabilitetin i cili njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si shpenzim në mënyrë sistematike përgjatë jetës së dobishme të aktiveve, gjatë periudhës ushtrimore.

28. *Amortizimi (tatimore)* është përlllogaritje e shpenzimeve nga entiteti sipas parimeve të ligjit për kontabilitetin i cili njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si shpenzim me metodën lineare gjatë periudhës tatimore, duke respektuar kushtet e nenit 51, të ligjit nr. 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”.

29. *Shpenzime interesi dhe shpenzime të tjera të ngjashme (ushtrimore)* janë shpenzime të përlllogaritura nga entiteti sipas ligjit për kontabilitetin për interesat dhe shpenzimet e tjera të ngjashme të pasqyruara në PASH gjatë periudhës ushtrimore.

30. *Shpenzime interesi dhe shpenzime të tjera të ngjashme (tatimore)* janë shpenzime të përlllogaritura nga entiteti për interesat dhe shpenzimet e tjera të ngjashme të pasqyruara në PASH, referuar kufizimeve të përcaktuara në nenin 30 të ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, gjatë periudhës tatimore.

31. *Shpenzime të tjera financiare (ushtrimore)* janë shpenzime financiare të përlllogaritura nga entiteti sipas ligjit për kontabilitetin që nuk përfshin interesat dhe shpenzimet e tjera të ngjashme të pasqyruara në PASH gjatë periudhës ushtrimore.

32. *Shpenzime të tjera financiare (tatimore)* janë shpenzime financiare të përlllogaritura nga entiteti që nuk përfshin interesat dhe shpenzimet e tjera të ngjashme të pasqyruara në PASH, sipas përcaktimeve të nenit 31 të ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, gjatë periudhës tatimore.

33. *Shpenzime të tjera (ushtrimore)* janë shpenzime kontabël të përlllogaritura sipas ligjit për kontabilitetin, që nuk përfshihen në rubrikat: 21, 23, 25, 27, 29, 31.

34. *Shpenzime të tjera (tatimore)* janë shpenzime tatimore të përlllogaritura nga entiteti, që nuk përfshihen në rubrikat 22, 24, 26, 28, 30, 32.

35. *Shpenzimet total (ushtrimore)* janë shuma e shpenzimeve të llogaritura nga entiteti referuar rubrikave 21, 23, 25, 27, 29, 31, 33 gjatë periudhës ushtrimore.

36. *Shpenzimet total (tatimore)* janë shuma e shpenzimeve të llogaritura nga entiteti referuar rubrikave 22, 24, 26, 28, 30, 32, 34 gjatë periudhës tatimore.

37. *Shpenzimet e pazbritshme* janë shpenzime të cilat nuk i kanë shërbyer drejtpërsëdrejti ushtrimit të aktivitetit, si dhe plotësojnë kushtet e nenit 50 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”.

Rezultati

38. *Humbja (ushtrimore)* është diferenca midis shumës së shpenzimeve ushtrimore dhe shumës së të ardhurave ushtrimore $(38) = (35) - (19)$, me kushtin që $(35) > (19)$.

39. *Humbja (tatimore)* është diferenca midis shumës së shpenzimeve tatimore dhe shumës së të ardhurave tatimore përfshirë shpenzimet e pazbritshme $(39) = (36) - (37) - (20)$, me kushtin që $[(36) - (37)] > (20)$.

40. *Fitimi (ushtrimor)* është diferenca midis shumës së të ardhurave ushtrimore me shumën e shpenzimeve ushtrimore $(40) = (19) - (35)$ kur $(19) > (35)$.

41. *Fitimi (tatimor)* është diferenca midis shumës së të ardhurave tatimore plus shpenzimeve jo të zbritshme me shumën e shpenzimeve tatimore. $(41) = (20) + (37) - (36)$, me kushtin që $[(20) + (37)] > (36)$.

42. *Humbje e mbartur* është humbja e mbartur nga periudhat paraardhëse dhe që njihet për efekte tatimore për t’u mbuluar nga fitimet e periudhës që deklarohet. Shuma e mbartur nuk mund të kalojë fitimin e periudhës tatimore. $42 \leq 41$.

43. *Fitimi i tatueshëm*, është fitimi tatimor duke zbritur humbjen e mbartur (nëse ka). $(43) = (41) - (42)$.

Llogaritja e tatimit mbi të ardhurat e korporatës.

Përzgjedhja e kutizës me përmbajtjen: “Përcakto vlerën për kuti (44) (46) (48)”, do të bëhet në rastet kur, tatimpaguesi do të zbatojë shkallë tatimore të ndryshme nga ato standarde ose do të zbatojë disa shkallë tatimore.

44. *Baza e tatueshme*, është fitimi i tatueshëm mbi të cilin do të zbatohet shkalla standarde tatimore 15%.

45. *Tatimi mbi të ardhurat e korporatës me shkallë tatimore standarde 15%* është shuma e tatim fitimit korporativ e llogaritur për vitin tatimor me shkallën standarde 15% për entitetet me të ardhura mbi 14 (katëmbëdhjetë) milionë lekë.

46. *Baza e tatueshme*, është fitimi i tatueshëm mbi të cilin do të zbatohet shkalla standarde tatimore 5%.

47. *Tatimi mbi të ardhurat e korporatës me shkallë tatimore të reduktuar 5%*, është shuma e tatim fitimit korporativ e llogaritur për vitin tatimor me shkallën e reduktuar 5%, për entitetet e përcaktuara në nenin 69 (lehtësitë tatimore) të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”.

48. *Baza e tatueshme*, është fitimi i tatueshëm mbi të cilin do të zbatohen shkallët tatimore me përçindje të tjera (nëse ka), të ndryshme nga shkallët standarde tatimore.

49. *Tatimi mbi të ardhurat e korporatës me shkallë tatimore të tjera* është shuma e tatim fitimit korporativ e llogaritur për vitin tatimor me shkallët tatimore të tjera të ndryshme nga shkallët standarde tatimore.

50. *Totali i tatimit*, është shuma totale e tatimeve të llogaritura me të gjitha shkallët tatimore që janë zbatuar. $50=45+47+49$.

51. *Kreditimi i tatimit të huaj* është shuma e tatimit të huaj të paguar për të ardhurat tatimore që entiteti realizon jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë gjatë periudhës tatimore. Shuma e tatimit të huaj të kredituar nuk mund të kalojë shumën e tatimit të pagueshëm sikur këto të ardhura të realizoheshin në Republikën e Shqipërisë.

52. *Kreditimi i tatimit të mbajtur në burim*, është shuma e tatimit të mbajtur dhe paguar në zbatim të nenit 58, të ligjit për tatimin mbi të ardhurat, e cila kreditohet për tatimpaguesit e regjistruar në Republikën e Shqipërisë.

53. *Tatimi mbi të ardhurat e korporatës i shtyrë* është shuma e llogaritur e tatimit korporativ, e cila për shkak të lehtësive tatimore (nëse ka) nuk duhet të paguhet në organet tatimore, por vetëm të rezervohet dhe të paguhet në rast të thyerjes së kushtit për të cilin është përfituar lehtësia tatimore.

54. *Tatim mbi të ardhurat e korporatës i detyrueshëm për t’u paguar* është shuma e tatimit mbi të ardhurat e korporatës me shkallë tatimore standarde 15%, tatimit mbi të ardhurat e korporatës me shkallë tatimore të reduktuar 5%, tatimit mbi të ardhurat e korporatës me shkallë tatimore të tjera minus vlerën e kreditimit të tatimit të huaj, kreditimit të tatimit të mbajtur në burim dhe tatimit mbi të ardhurat e korporatës të shtyrë $(54)=(50)-(51)-(52)-(53)$.